



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 150, Datë 10.06.2022

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA”  
SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; pika 5, pika 1 gërma “e”; 13, nenit 16, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 900/2 prot., datë 09.06.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k., me nr. 374 seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 109, datë 19.05.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 374 Seria T17, të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE me shkresën nr. 70/19 prot., datë 20.05.2022, bëri njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.06.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “b”, “c” dhe “d”.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b” dhe “d”.
- Në lidhje me Dokumentacionin financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërma “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore), **i cili është konsideruar i plotësuar pjesërisht pasi shoqëria rezulton në një proces apelimi të disa gjobave mbi Tatimin mbi Fitim dhe Tatim mbi Vlerën e Shtuar, vlerësohet t’i lihet si kusht në vendimin e rinovimit të licencës shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., që në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE Vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.**
- Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet për pagesat rregullatore ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me nr. 374 Seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017, për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke filluar nga data 04.07.2022.
2. Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k. në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE, vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të vendimmarrjes së organit tatimor në përfundim të procesit të vlerësimit mbi procesin e apelimit të nisur nga shoqëria “Danske Commodities Albania”sh.p.k., që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimmarrjeje.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqytjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.